



Kodi i Matjes së Energjisë Elektrike Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Prishtinë

Dhjetor2020



PËRMBAJTJA

Kodi i Matjes së Energjisë Elektrike i OSSh	4
1. Pjesa e përgjithshme e Kodit të Matjes së OSSh.....	5
1.1.HYRJE	5
1.2.HIERARKIA E RREGULLAVE TË MATJES	6
2. Fushëveprimi, Qëllimet dhe Standardet e Shfrytëzuara	6
2.1.FUSHËVEPRIMET KRYESORE TË KËTIJ KODI	6
2.2.QËLLIMET E KODIT PËR MATJE TË OSSH.....	8
2.3.STANDARDET REFERENTE	8
3. Pika Matëse.....	10
3.1.PËRSHKRIMI.....	10
3.2.PRONËSIA.....	10
3.3.E DREJTA PËR INSTALIMIN E NJEHSORËVE TË ENERGISË DHE QASJA NË PRONË.....	10
3.4.SIGURIA.....	11
3.5.OPERIMI DHE MIRËMBAJTJA E SISTEMIT TË NJEHSORËVE	11
3.6.KËRKESAT TEKNIKE MINIMALE PËR NJEHSORË DHE LLOJET E TYRE	12
3.7.STANDARDET MINIMALE PËR PAJISJET MATËSE.....	19
3.8.SISTEMI PËR TESTIM DHE KALIBRIM.....	19
3.9.INSPEKTIMI DHE TESTIMET NË TEREN.....	20
3.10. PLOMBIMI I PAJISJEVE MATËSE.....	22
4. Evidentimi dhe Operimi me Pikën Matëse	24
4.1 LEXIMI I NJEHSORIT, GRUMBULLIMI DHE SHKARKIMI I TË DHËNAVE NË DATA BAZË.....	24
4.2 E DREJTA PËR QASJE NË TË DHËNAT E NJEHSORIT	24
4.3 OPERIMI DHE MIRËMBAJTJA E SISTEMIT TË NJEHSORËVE MATËS	25
4.4 DISPOZITAT E KODIT TË MATJES PËR FURNIZIMIN E KONSUMATORËVE ME ENERGI ELEKTRIKE.....	25
4.5 ZËVENDËSIMI I NJEHSORËVE TË PRISHUR DHE ATYRE QË DUHET TË KALIBROHEN.....	25



4.6 MEKANIZMAT PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE	26
4.7 NJEHSORËT SPECIAL	26
4.8 NJEHSORËT MATËS PËR KONSUMATORËT E TL, TM DHE TU ME MATJE MULTIFUNKSIONALE	27
4.9 PROCEDURAT E MATJES PËR KONSUMATORËT E TU ME MATJE DIREKTE.....	30
4.10 TËRËSIA E PIKËS MATËSE.....	32
4.11 DEFECTET NË MATJE DHE SAKTËSIA E MATJES.....	32
5. Emërtimet e shfrytëzuara në Kodin e Matjes së OSSh-së.....	34
6. Shtojcat.....	46



Kodi i Matjes sëEnergjisë Elektrike OSSh-së

Kodi i Matjes është obligim ligjor i përgatitur fillimisht në vitin 2008 nga OSSh dhe OST dhe i aprovuar nga Rregullatori konform ligjeve në fuqi. Në vitin 2014 OSSh ka përditësuar Kodin e Matjes për t'ju përshtatur ndryshimeve ligjore ne sektorin e Energjise, i cili eshte përditësuar si i tille nga ZRRE-ja konform të drejtave dhënë përmes Ligjitpër Rregullatorin e Energjisë.

Ndryshimi i ri legjislativ gjatë vitit 2016 dhe 2017 sjell nevojën për përditësimin e Kodit të Matjes me qëllim të harmonizimit të kodit me ligjet primare dhe sekondare në fuqi. Ky është versioni i tretë i Kodin e Matjes sëEnergjisë Elektrike tëOSSh-së.

Ligji për Energjinë Elektrike në fuqi përkufizon Kodin e Matjes si tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike. Për me tepër Ligjit për Energji Elektrike thekson se përmes Kodit te Matjes përcaktohet dhe rregullohet mirëmbajtja e sistemeve matëse, mbledhja dhe procesimi i të dhënat nga pikat matëse komerciale të përdoruesve të rrjetit;përcakton kërkesat për kyçe në rrjetin e shpërndarjes, dhe përcakton kriteret për plasimin e energjisë elektrike në rrjet përmes pajisjeve matëse që duhet vendosur në kufi të sistemit të transmetimit apo sistemit të shpërndarjes me konsumatorët apo prodhuesit.

Kodi i Matjes së OSSH-së, përveç ligjeve primare dhe sekondare të energjisë elektrike, vepron edhe në përputhshmëri me Udhëzimet Administrative për matje dhe saktësinë e matjes të amendamentuara nga Ministria përgjegjëse



1. Pjesa e përgjithshme e Kodit të Matjes së OSSh

1.1. Hyrje

- 1.1.1. **Kodi për Matje të Energjisë Elektrike për Sistemin e Shpërndarjes (tani e tutje vetëm Kodi i Matjes) përshkruan në mënyrë të përgjithshme rregullat për aplikimin e matjeve të energjisë elektrike në pjesë të ndryshme të Sistemit të Shpërndarjes, për kategori të ndryshme të konsumatorëve dhe Shfrytëzuesvetë ndryshëm të Sistemit të Shpërndarjes. Gjithashtu Kodi i Matjes duhet të mbulojë matjet që bëhen në Gjeneratorët e Pavarur që janë të kyçur në mënyrë direkte në Sistemin e Shpërndarjes.**
- 1.1.2. **Kërkesat për matjet që bëhen në pikat shkëmbyese në mes të Sistemit të Transmetimit dhe atij të Shpërndarjes, duhet të mbuloohen nga kodi i matjes së OST-së dhe do të plotësohen edhe kërkesat nga ky kod.**
- 1.1.3. Rregullat e **Kodit të Matjes** së energjisë elektrike të **OSSH-së** kanë për qëllim që të rregullojnë matjen e energjisë elektrike për konsumatorët që janë të kyçur në rrjetin e **OSSH-së** dhe do të shfrytëzohen nga **Furnizuesit e Licencuar** të cilët bëjnë furnizimin me energji elektrike në territorin e Republikës së Kosovës.
- 1.1.4. Rregulla që përcakton matjen e energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët dhe prodhuesit e energjisë elektrike përfshihet në **Kodin e Matjes** së **OSSH-së**, gjegjësisht **Kodine Matjes** së Energjisë Elektrike të OST-së.
- 1.1.5. Kodi për Matje të Energjisë Elektrike **do të jetë i aplikuar dhe duhet të zbatohet nga të gjithë shfrytëzuesit në Sistemin e Shpërndarjes duke përfshirë:**
- Çdo **OSSH** i Licencuar që duhet të operojë nën kushtet që i janë përcaktuar me Licencë;
 - OSSH-të** e tjerë të Licencuar, që janë të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**;
 - Konsumatorët fundorë** që janë të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes, përfshirë edhe konsumatorët Vet-prodhues**;
 - Gjeneratorët e Pavarur** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**; dhe



- e. Çdo **konsumatorë** që furnizohet nga **Gjeneratorët e Pavarur** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**.

1.2. Hierarkia e Rregullave të Matjes

- 1.2.1 Hierarkia e zbatimit të këtij **kodi të matjes** së energjisë elektrike, në të gjitha dokumentet zyrtare për matje, do të jetë e bazuar në renditjen e listës së dhënë më poshtë:
- a. Ligjet primare (bazike):Ligji për Rregullatorin e Energjisë në fuqi, Ligji Nr. për Energjinë në fuqidhe Ligji për Energjinë Elektrike në fuqi
 - b. Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
 - c. Udhëzimet Administrative për matje dhe saktësi të matjes
 - d. **Kodi i Matjes** së **OST**-së;
 - e. Kodi i Matjes së **OSSH**-së

2. Fushëveprimi, Qëllimet dhe Standardet e Shfrytëzuara

2.1. Fushëveprimet Kryesore të këtij Kodi

- 2.1.1 Sipas këtij Kodi duhet që të definohen standardet minimale të pranueshme që do të kenë efekt në matje të saktë të energjisë elektrike me të cilën shërbehen**konsumatorët, prodhuesit** dhe **shfrytëzuesit**, të përshtatshme për qëllim të faturimit konform Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, respektivisht, sipas strukturës tarifore të aprovuar nga Rregullatori dhe në përputhje me tarifën e dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme).
- 2.1.2 Ky **Kod**përmban rregullat e operimit të përshtatshme dhe eficientetë pikave matëse, duke ofruar mundësitë sa më ekonomike në shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike,duke përmbajtur të gjitha ndërlidhjet që duhet t'i përshtaten këtij Kodi.
- 2.1.3 Kriteret më të rëndësishme të **Kodit për Matje** të **Sistemit të Shpërndarjes** janë:



- i. Çdo **pikë kyçëse-shkëmbyese** duhet t'i ketë **pajisjet matëse të** instaluar për matje;
- ii. Pajisjet matëse duhen të jenë të regjistruara në regjistrin e pajisjeve matëse të certifikuara në Republikën e Kosovës, siç janë: **njehsorët, transformatorët matës** dhe pajisjet përcjellëse të cilat duhet të jenë të përshtatshëm për matje, duke përmblajtur edhe elementet e fuqisë, tarifave të aplikuara, dhe sasisë së energjisë aktive dhe (ose) reaktive që kalon nëpër atë **pikë të matjes**;
- iii. **OSSH** e Licencuar është përgjegjëse për kushtet e instalimit të **njehsorëve për matje** për të gjithë **konsumatorët** që furnizohen në përputhje me aktin e licencimit;
- iv. **OSSH** duhet të sigurojsaktësi në vazhdimësi për të gjithë **njehsorët** e instaluar për matje të cilët duhet të plotësojnë standardet relevante ndërkombëtare për matje të energjisë elektrike;
- v. **Njehsorët** e instaluar duhet të jenë të sigurt, dhe të kenë qasje të lehtë për t'u lexuar dhe për t'u mirëmbajtur nga **OSSH**;
- vi. Çdo **Furnizues** i Licencuar, që merret me shitjen e energjisë elektrike për **konsumatorët** që furnizohen, mund të jetë i autorizuar që të ketë qasje për lexim të këtyre **njehsorëve**;
- vii. Operatori i Sistemit mund t'ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, Operatori i Sistemit mbetet përgjegjës për të siguruar lexim të saktë dhe të rregullt, në përputhje me kete Kod.
- viii. Për **njehsorë elektronik** që janë të instaluar për **konsumatorët fundorë**, personat e autorizuar nga **OSSH** dhe/ose personat përgjegjës të Labororit për testimin e njehsorëve në kaudër të Ministrisë përgjegjësenë prezencën e personave të autorizuar të OSSH-së kanë të drejtë të bëjnë kontrollimin softuerik të **njehsorit**;
- ix. **eOSSH** duhet të ruaj në njehsorë elektronikë historinë e të dhënave për gjendjet e njehsorëve që kanë të bëjnë me faturim (një herë në muaj) për së paku 12 muaj dhe këto të dhëna arkivohen në databazën përkatëse të OSSH-së për së paku 5 vjet;
- x. OSSH ka te drejte te vendos njesore kontrollues, si dhe t'i kontrolloj **njehsorët** e matjes kontrolluese, ashtu si kërkohet nga ky **Kod**, dhe mund te perdoren për nxjerrjen e të dhënave atëherë kur **njehsorët kryesor** të matjeve janë në prishje apo per arsye tjera;



xi. Komisioni i përcaktuar nga ana e Ministrisë përgjegjëse është përgjegjës për auditimin e **njehsorëvetë** instaluar për matje, ashtu që të jenë në përputhshmëri me kushtet e këtij Kodi;

2.2. Qëllimet e Kodit për Matje të OSSh

2.2.1. **Kodi për Matje** mbulon rekomandimet dhe praktikat që duhet të përdoren dhe specifikat e pajisjeve që duhet të sigurohen për matjen dhe regjistrimin e **njehsorëve** të ndryshëm, siç janë **njehsorët** për matjen e energjisë aktive dhe reaktive me të gjithë parametrat përkatës.

2.2.2. Matja edhe të parametrave tjerë siç janë: fuqi aktive dhe reaktive, **faktori i fuqisë**, tensioni, rryma, frekuenca etj.

2.2.3. Specifikon kërkesat për kalibrimin, testimin dhe komisionimin e **njehsorëve** dhe pajisjeve matëse si dhe pjesëve tjera që nevojiten për matje.

2.2.4. Kodi bënë përshkrimin e përgjithshëm të specifikimeve teknike për elemente të ndryshme matjeje.

2.2.5. Përshkrimi i leximeve të **njehsorëve**, komunikimit dhe menaxhimittë të dhënave.

2.2.6. Procedurat për vlerësimin e konsumit kur **njehsorët** dhe pajisjet matëse përcjellëse janë në defekt si dhe çështjeve diskutabile në lidhje me konsumin nga ana e **konsumatorit, i cili** duhet të zbatohet dhe udhëhiqet nga komisioni i përcaktuar në bazë të procedurave të veçanta.

2.3. Standardet Referente

2.3.1. Standardet Internacionale që duhet të aplikohen për matje dhe që duhet të përdoren për **njehsorët matës**, për pajisjet përcjellëse si dhe për sistemet e llogaritjes dhe pagesave janë:

Nr. Standardit

Titulli i Standardit (në gjuhën Angleze)



IEC 62053-22 Ed. 1.0 (2003) e zëvendëson standardin IEC 60687	Specification for AC Static Wat-hour Meters for Active Energy (Classes 0.2s and 0.5s)
IEC 62053-21	Alternating Current Static Wat -hour Meters for Active Energy (Classes 1 and 2)
IEC 62053-24	Alternating Current Static VAR-hour Meters for Reactive Energy (Classes 0,5S,1S and 1)
IEC 60044-1 &2	Instrument transformers - Current transformers & Instrument transformers - Inductive voltage transformers
IEC 60338	Telemetry for consumption and demand
IEC 62055-31	Electricity metering - Payment systems

Përdorimi i indekseve të saktësisë A, B dhe C janë në përputhshmëri me standardet e sipërshënuara andaj janë edhe të aplikueshme dhe në harmoni të plotë me saktësitë e theksuar.

Sipas rregullores MID:

- 1.Klasa e saktësisë cl.2 është ekuivalentë me cl.A,
- 2.Klasa e saktësisë cl.1 është ekuivalentë me cl.B,
- 3.Klasa e saktësisë cl.0.5 është ekuivalentë me cl.C,

Nëse është shënuar klasa e saktësisë c.2, cl.1. cl.0.5 të gjitha të dhënat për këtoklasa të saktësisë nënkuptojnë edhe klasat e saktësisë sipas MID.

Një listë më e gjerë e Standardeve të IEC-së është dhënë në Shtojcat 1 (**Njehsorët Matës**), Shtojca 2 (**Transformorët Matës të Rrymës - TMRR**) dhe Shtojca 3 (**Transformorët Matës të Tensionit - TMT**).



3. Pika Matëse

3.1. Përshkrimi

Pika matëse është pika ku bëhet matja e shkëmbimit të energjisë elektrike në mes të **Sistemit të Shpërndarjes**, të **Sistemit të Transmetimit**, **Prodhuesit**, **konsumatorëve**, **konsumatorëve vet-prodhues** dhe **shfrytëzuesvetjerë**, kufiri ndarës i aseteve përcaktohet sipas metodologjisë përkatëse për kyçje.

3.1.1. Pajisjet matëse që vendosen në **pikat matëse** duhet që të matin rrjedhjen e energjisë elektrike, siç është **Energjia Aktive** dhe **Reaktive**, dhe **Fuqia Aktive** dhe **Reaktive**, në mënyrë të saktë në çdo interval të caktuar kohor.

3.2. Pronësia

3.2.1 **Sistemet matëse** janë pronë e **OSSH-së**, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike në fuqi.

3.2.2 Në nënstacionet 220/35/10(20)kV dhe 110/35/10(20)kV, **Njehsorët** e vendosur në daljet distributive në anën e tensionit të mesëm (35kV, 20kV dhe 10kV) janë pronë e **OSSH-së**, përveç matjeve zyrtare në mes OST dhe OSSH ku pronar është OST.

3.3. E Drejta për Instalimin e Njehsorëve të Energjisë dhe Qasja në Pronë

3.2.3 **OSSH** ose ndonjë operator i autorizuar nga OSSH do të instalojë **sistemin matës** jashtë objektit të banimit.

3.2.4 **Konsumatori** duhet që të sigurojë hapësirë të nevojshme për **sistemin matës**, pa marrë parasysh pronësinë e hapësirës si dhe të lejojë qasje për personelin e autorizuar të **OSSH-së** të **sistemi i njehsorëve**, konform Ligjit për Energjinë në fuqi dhe Rregulles për kushte të përgjithshme të furnizimit me energji.

Njehsorët mund të vendosen edhe në vendin e kufirit ndarës të aseteve, përkatësisht te rastet e RRTU ajrore në piken më të afërt të mundshme nga objekti i **konsumatorit**, duke marrur pelqimet nga organet kompetente, ose në rastet për prone private, atëherë pelqimi duhet të merret nga pronari.

3.2.5 **Vendi** që zgjidhet për vendosjen e pajisjeve matëse, në çdo rast, duhet të jetë:



- i. I përshtatshëm dhe me qasje të lehtë në të dhënat e njehsorit duke përfshirë edhe çasjen përmes pajisjeve të ndryshme teknologjike të cilat e mundësojnë atë;
- ii. Të jetë në vend ku nuk ka mbeturina, plehra të ndryshëmdhe çdo vend ku nuk ka mjete të djegshme dhe hapësira kuvendoset(n) **njehsori (njehsorët)** mos të përdoret për qëllime tjera;
- iii. I mbrojtur nga mundësia e hyrjeve të kafshëve që mund të shkaktojnë dëme;
- iv. Në distancë minimale (1.5m) nga toka, perveq ne rast kur ormani vendoset ne toke.

3.3.4 Varësisht prej lokacionit dhe mënyrës së vendosjes, sistemi matës mund të jetë i vendosur por jo i kufizuar:

- i. në pronën, gjegjësisht objektin që është në pronësi të konsumatorit. Përgjegjës për sigurinë, përkujdesin dhe mbarëvajtjen e punës së sistemit matës është OSSH.
- ii. në pronën, gjegjësisht në objektin e përbashkët të disa konsumatorëve.
- iii. jashtë pronës së konsumatorit, në pronësi publike.
- iv. përgjegjës për sigurinë, përkujdesin dhe mbarëvajtjen e punës së sistemit matës është OSSH. OSSH do të bëjë inspektimet e rregullta të këtyre sistemeve matëse. Për çdo dëmtim fizik, dyshim ose rrezik, konsumatorët duhet të raportojnë organet kompetente (OSSH-në, personin apo kompaninë e autorizuar, policinë, etj.). OSSH i përgjigjet në kohë sa më të shkurtër kërkesës-lajmërimit të konsumatorit.

3.4. Siguria

3.4.1. Kutia duhet të ju përshtatet standardeve relevante ndërkombëtare, siç është rezistenca ndaj zjarrit, lagështisë dhe sigurisë së tensionit goditës etj.

3.5. Operimi dhe Mirëmbajtja e Sistemeve matëse

3.5.1. **Operimi dhe mirëmbajtja** e Sistemeve matëse përfshinë: instalimin fillestar të bërë në bazë të standardeve të kërkuara, **mirëmbajtjen** e rregullt – përfshirë testimet sistematike dhe certifikimi, ndërrimin e njësive të veçanta dhe njehsorëve,



kontrollimin e **TMRR**, **TMT** dhe **njehsorëve** tjerë, instalimin e përcuesve, terminimin, shtrirjen e mirëfilltë të kablllove, mbrojtjen, leximete rregullta dhe periodike të **njehsorëve** si dhe nxjerrjen e të dhënave nga **njehsori**, **mirëmbajtjen** e **Qendrës Grumbulluese të të Dhënave** si dhe vëmendjen për ndonjë prishje eventuale të sistemit të **njehsorëve matës**, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësit e OSSH-së -së të përcaktuara në Ligjin Për Energjinë Elektrike në fuqi.

3.5.2. Mirëmbajtja e njehsorëve është përgjegjësi e **OSSH**-së.

3.6. Kërkesat Teknike Minimale për Njehsorë dhe Llojet e Tyre

3.6.1. Njehsorët që do të përdoren do të jenë të përshtatshëm për matjen e energjisë aktive dhe reaktive, totale dhe absolute dhe madhësi të tjera elektrike sipas kategorisë së konsumit, **në mënyrë të saktë** dhe do të përmbushë standardet për tarifën e kërkuara dhe të përcaktuara nga **Rregullatori** apo në marrëveshje me konsumatorin (nëse është e mundur).

3.6.2. Tipi i **njehsorëve** që do të përdoret, do të varet nga ngarkesat/kërkesat e ngarkesës në bazë të kontratës, si dhe nga kategoria e **konsumatorit** e përcaktuar në bazë të llojit të shpenzimit. Specifikimi teknik minimal për **njehsorët** e energjisë elektrike për çdo lloj të **njehsorëve**, është dhënë në bazë të standardeve përkatëse të **IEC**-së për çdo lloj të **njehsorëve matës** si dhe për **Transformatorët Matëstë Rrymës dhe Tensionit**.

3.6.3. Karakteristikat tjera teknike në aspektin e vlerave nominale, qëndrueshmëria, aplikimi, vlerat e testimeve themelore, mbrojtja, siguria, etj. do të jenë të përshkruara në **Kodin e Shpërndarjes**, Rregulloret Teknike, Standardet Teknike IEC, ndërsa ky Kod më tepër përkufizohet në aspektin e përzgjedhjes, aplikimit, sigurisë dhe saktësisë së matjes.

3.6.4. Klasët e lejuara (cl) të pajisjeve matëse sipas a) ngarkesës (ngarkesës – fuqisë) dhe b) sipas tensionit janë të prezantuara në tabelat në vijim:

a) Klasët e lejuara (cl) të pajisjeve matëse sipas ngarkesës



Klasa e Saktësisë (cl)					
Fuqia Maksimale e Kërkuar	>50MVA	10-50MVA	1-10 MVA	<1 MVA	<50 KVA
Tr. Matës Rrymorë	0.2s	0.2 S	0. 2S	0.2S	0.5
Tr.Matës Tensioni	0.2s	0.2	0.5	0.5	-----
Njehsorët e en. aktive	0.2s	0.2 s	0.2	0.5	1.0
Njehsorët e en. reaktive	0.5	0.5	0.5	1	2*

**Energjia reaktive përdoret te konsumatorët që kanë të kyçur prodhues në rrjetin 0.4 kV me matje direkte*

b) Klasët e lejuara (cl) të pajisjeve matëse sipas tensionit

Tensioni	35 kV	10 (20) kV	0.4 kV (matje gjysmëindirekte)	0.4 kV (matje direkte)
Tr. Matës Rrymorë	0.2 s	0.2 S	0. 5	
Tr. Matës Tensioni	0.2 s	0.2		
Njehsorët e en. aktive	0.2 s	0.2 s	0.5 S	1
Njehsorët e en. reaktive	0.5	0.5	1	2*

**Energjia reaktive përdoret te konsumatorët që kanë të kyçur prodhues në rrjetin 0.4 kV me matje direkte*

Përzgjedhja e klasës më të lartë se ajo e lejuar do të jetë përparësi, por jo e obligueshme.

3.6.5. Kufijtë e saktësisë së pajisjeve matëse janë përcaktuar me klasën e saktësisë dhe kanë kuptimin si në vijim: cl 0.5 do të thotë se kufijtë e gabimit të kësaj pajisje



matëse janë $\pm 0.5\%$. Ngjashëm nënkuptohet edhe për rastet tjera si p.sh. cl2.0 ka kufijtë maksimal të gabimit $\pm 2.0\%$,etj.

Tabela në vijim paraqet kufijtë maksimal të lejuar të gabimit në të dy anët $\pm \%$ në përqindje për të gjitha llojet e njehsorëve (matësve dhe matësve multi-funksionale), në aplikim për matjen e energjisë elektrike aktive në Republikën e Kosovës.

Për njehsorët direkt vlerat për tabelat në vijim janë marrë nga standardi IEC 62053-21, ndërsa për njehsorët Indirekt/Gjysmë-indirekt vlerat janë marrë nga standardi IEC 62053-22.

Vlera e Rrymës (sistem të balancuar nëse nuk shprehet ndryshe)				Përqindja e lejuar e gabimit $\pm n\%$ për njehsor të klasës			
Për Njehsorë Direkt	Për Njehsorë Indirekt/ Gjysmë-indirekt	Faktori i fuqisë	0.2	0.5	1	2	
$0.05 I_b \leq I < 0.1 I_b$	$0.01 I_n \leq I < 0.05 I_n$	1	0.4	1.0	1.5	2.5	
$0.1 I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.05 I_n \leq I \leq I_{max}$	1	0.2	0.5	1.0	2.0	
$0.1 I_b \leq I < 0.2 I_b$	$0.02 I_n \leq I < 0.1 I_n$	0.5 induk.	0.5	1.0	1.5	2.5	
$0.1 I_b \leq I < 0.2 I_b$	$0.02 I_n \leq I < 0.1 I_n$	0.8 capac.	0.5	1.0	1.5	-	
$0.2 I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1 I_n \leq I \leq I_{max}$	0.5 induk.	0.3	0.6	1.0	2.0	
$0.2 I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1 I_n \leq I \leq I_{max}$	0.8 capac.	0.3	0.6	1.0	-	
Vlera e Rrymës (sistem të balancuar nëse nuk shprehet ndryshe)				Përqindja e lejuar e gabimit $\pm n\%$ për njehsor të klasës			
Për Njehsorë Direkt	Për Njehsorë Indirekt	Faktori i fuqisë	0.2	0.5	1	2	
Njehsorët trefazorë me ngarkesë njëfazore me tensione të balancuara							



$0.1 I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.05 I_n \leq I \leq I_{max}$	1	0.3	0.6	2.0	3.0
$0.2 I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1 I_n \leq I \leq I_{max}$	0.5 induk.	0.4	1.0	2.0	3.0
Me kërkesa speciale të shfrytëzuesve						
$0.2 I_b \leq I \leq I_b$	$0.1 I_n \leq I \leq I_{max}$	0.25 indu.	0.5	1	3.5	-
$0.2 I_b \leq I \leq I_b$	$0.1 I_n \leq I \leq I_n$	0.5 capac.	0.5	1.0	2.5	-

3.6.6. Kushti minimal që duhet të plotësojë **sistemi matës (GM)**, do të përcaktohet me kufijtë e saktësisë, ky përcaktim mbërthen në vete të gjitha gabimet përmbledhëse nga çdo element i sistemit matës përfshirë edhe ndërlihdjet – implikimi në saktësi i përcësuesve dhe lidhjeve.

Kufijtë e tolerancës së gabimit të tërësisë së sistemeve matëse, për **energjinë aktive** janë paraqitur në tabelën në vijim:

Kushti	Kufijtë e gabimit të Energjisë Elektrike Aktive sipas faktorit të fuqisë					
	Faktori i fuqisë $\cos\phi$	Kufijtë e gabimit të Pikës Matëse (+/-)				
		>50MVA	10-50MVA	1-10MVA	<1MVA	<50kVA
10%-120%	1	0.5%	0.5%	1.0 %	1.0 %	2.0%
5%-10%	1	0.7%	0.7%	1.0%	1.0%	2.0%
1%-5%	1	1.0%	1.0%	1.5%	1.5%	2.5%
10%-120%	0.5(-)	1.0%	1.0%	1.5%	1.5%	3.0%
10%-120%	0.5(+)	1.0%	1.0%	1.5%	1.5%	3.0%

Ndërsa kufijtë e tolerancës së gabimit të tërësisë së sistemeve matëse për energjinë reaktive janë si në vijim:



Kushti	Kufijtë e gabimit të Energjisë Elektrike Reaktive sipas faktorit të fuqisë				
Rryma e shprehur si përqindje e vlerës së rrymës së matur	Faktori i fuqisë	Kufijtë e gabimit të Pikës Matëse (+/-)			
		>50MVA	10-50MVA	1-10 MVA	<1 MVA
10%-120%	0	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%
20%-120%	0.866(-)	4.0%	4.0%	4.0%	4.0%
20%-120%	0.866(+)	4.0%	4.0%	4.0%	4.0%

3.6.7. Variacionet e tensionit, frekuencës, temperaturës, sekuenca reverse dhe harmonikët do të ndikojnë në saktësi dhe gabimet mund të rriten edhe deri në trefishin e klasës së aplikuar.

Tabela mbi ndikimet e faktorëve të jashtëm në saktësinë e njehsorëve dhe vlerat maksimale të lejuara të gabimeve të lejuara; temperatura dhe asimetria:

Ndikimi Madhësisë	Faktori i fuqisë	Vlera e Rrymës (balancuar nëse nuk shprehet ndryshe)		Koeficienti mesatar i temperaturës [%/K] tejkalimi / gabimi (limiti)(+/-) për njehsor të klasës			
		Për Njehsorë Direkt	Për Njehsorë indirekt	0.2	0.5	1	2
Variacionet e temperaturës së ambientit	1	$0.1I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.05I_n \leq I \leq I_{max}$	0.01	0.03	0.05	0.10
	0.5 ind.	$0.2I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1I_n \leq I \leq I_{max}$	0.02	0.05	0.07	0.15
Njehsorët trefazorë me ngarkesë njëfazore (me	1	$0.1I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.05I_n \leq I \leq I_{max}$	0.3	0.6	2.0	3.0
	0.5 ind.	$0.2I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1I_n \leq I \leq I_{max}$	0.4	1.0	2.0	3.0



Rryma fillestaree njehsorëve duhet të jetë sipas prezantimit në tabelën në vijim:

Njehsori (Matësi)		Për njehsor të klasës			
Mënyra e kyçjes	Faktori i fuqisë	0.2	0.5	1	2
Kyçje Direkte	1	-	0.005 I _b	0.004 I _b	0.005 I _b
Kyçje përmes TMRR-ve	1	0.001 I _b	0.002 I _b	0.002 I _b	0.003 I _b
Kyçje përmes TMRR-ve e TMT-ve	1	0.001 I _b	0.001 I _b	0.002 I _b	-

Tabela mbi ndikimet e faktorëve të jashtëm në saktësinë e njehsorëve dhe vlerat maksimale të lejuara të gabimeve të lejuara; tensioni, frekuenca, harmonikët etj.

Madhësia e ndikimit	Faktori i fuqisë	Vlera e Rrymës (balancuar nëse nuk shprehet ndryshe)		Limiti i variacionit të gabimit në përqindje (+/-) për njehsor të cl.			
		Për Njehsorë Direkt	Për Njehsorë indirekt	0.2	0.5	1	2
Variacioni i Tensionit ± 10 %	1	$0.05I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.05I_n \leq I \leq I_{max}$	0.1	0.2	0.7	1.0
	0.5 ind.	$0.1I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1I_n \leq I \leq I_{max}$	0.2	0.4	1.0	1.5
Variacioni i Frekuencës ± 2 %	1	$0.05I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.05I_n \leq I \leq I_{max}$	0.1	0.2	0.5	0.8
	0.5 ind.	$0.1I_b \leq I \leq I_{max}$	$0.1I_n \leq I \leq I_{max}$	0.1	0.2	0.7	1.0



Sekuena inverze fazore	1	$0.1 I_b$	$0.1 I_n$	0.05	0.1	1.5	1.5
Tensionet e pabalancuara	1	I_b	I_n	0.5	1	2	4
Komponentët e Harmonikëve	1	$0.5 I_{max}$	$0.5 I_{max}$	0.4	0.5	0.8	1.0
Nën-Harmonikët e rrymës	1	$0.5 I_b$	$0.5 I_n$	0.6	1.5	3.0	6.0
Fusha kontin. magn. e jashtme	1	I_b	I_n	2.0	2.0	2.0	3.0
Induksioni mag. i jasht. 0.5 mT	1	I_b	I_n	0.5	1.0	2.0	3.0
Fusha elektromag.RF	1	I_b	I_n	1.0	2.0	2.0	3.0
Akcesorët operues		$0.05 I_b$	$0.01 I_n$	0.05	0.1	0.5	1.0
Fushat radio-frekuencore të kontakteve	1	I_b	I_n	1.0	2.0	2.0	3.0
Goditjet kalimtare	1	I_b	I_n	1.0	2.0	4.0	6.0
Qëndrueshmëria në oscilimet valore të shuarseve	1	-	I_n	1.0	2.0	2.0	3.0

3.6.8. Saktësia e matjeve verifikohet sipas rregullave të Metrologjisë dhe në vlera testuese të ndryshme të cilat janë të përshkruara në detale në këto rregulla, të cilat i përpilon Agjencia e Metrologjisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë përgjegjëse.

3.6.9. Kushtet ambientale dhe stabiliteti elektrik gjatë testimeve laboratorike do të jenë të përshkruara në rregullat e AMK, të bazuara në standardet IEC 62053; 11, 21, 22, 23 dhe nuk janë subjekt i këtij Kodi.



3.6.10. Njehsorët matës të energjisë elektrike, **TMRR, TMT** me saktësi më të ulët se sa ato që kërkohen në specifikacionin me kërkesa minimale, do të mbahen në përdorim derisa të mundësohet ndërrimi i tyre.

3.7. Standardet Minimale për Pajisjet Matëse

3.7.1. Në rastet kur kërkohet nga Rregullatori të bëhet ndërrimi i tarifave, atehere OSSH dhe OST do të bëjnë pershtatjen e pajisjeve matëse me tarifën e reja, atëherë ai duhet të zbatojë rekomandimet e **Rregullatorit**

3.7.1.1 Koha e llogaritjes do të bëhet sipas kohës universale dhe ndërrimi i llogaritjes së kohës (koha verore dhe ajo dimërore) bëhet nga vetë njehsori ndërsa sinkronizimi i kohës reale të njehsorit bëhet përmes Qendrës së grumbullimit të të dhënave.

3.7.2. Atëherë kur përdoren tarifa të ndryshme që nënkupton çmime të ndryshme të energjisë elektrike varësisht nga ora e shfrytëzimit të energjisë elektrike, pajisjet matëse për energji elektrike duhet të kenë të instaluar njehsorin kohor (ora interne) ashtu siç kërkohet me anën e procedurave të Metrologjisë dhe Standardeve relevante ndërkombëtare si Standardet **IEC**.

3.7.3. Atëherë kur shitja e energjisë elektrike për **konsumatorë** të ndryshëm, bëhet në bazë kohore dhe duke pasur parasysh instalimin elektrik, matjet duhet të bëhen në çdo 15 minuta të vlerës së kërkesës, çdo periudhë e llogaritjes duhet të fillojë në orë të plotë, në çdo gjysmë ore dhe në çdo ¼ e orës.

3.8. Sistemi për Testim dhe Kalibrim

3.8.1. Miratimi, aprovimi, certifikimi, testimi dhe plumbimi i **njehsorëve matës** është përcaktuar në Ligjin për Metrologji dhe akteve nënligjore .

3.8.2. Të gjithë **njehsorët** dhe pajisjet matëse duhet të kalibrohen ose atestohen dhe pllombohen me pllomba shtetërore periodikisht sipas intervaleve të përcaktuara



dhe të definuara sipas prodhuesit gjegjësisht standardeve relevante ndërkombëtare IEC standardeve (SK EN ; 50470-3, 62056-21, 62052-11, 52056-46 dhe ato SK EN; 62053) për matje dhe sipas rregulloreve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse.

3.8.3. Regjistri i të dhënave për të gjithë **njehsorët** do të mirëmbahet nga njësitë i **OSSH**-së që tregon numrin serik të tyre, datën e instalimit, datën e tërheqjes nga përdorimi, datën e ri-instalimit si dhe numrin e plumbimit ashtu siç kërkohet me ligj dhe rregullat nga ana e **Rregullatorit**. Këto të dhëna mund të kërkohen në çdo kohë nga **Drejtoria e Metrologjisë**.

3.8.4. OSSH duhet të mbajë regjistrin e të gjithë **njehsorëve** që tregon numrin serik të tyre, numrin e plumbimit, datën e testimit, gabimin e shfaqur gjatë kohës së testimit, vlerën e saktësisë pas kalibrimit që të mundësojë kontrollimin e mundshëm në ndonjë periudhë të kërkuar kohore të përcaktuar sipas **Rregullatorit** dhe standardeve ndërkombëtare për energji elektrike.

3.9. Inspektimi dhe Testimet në Teren

3.9.1 **OSSH** bënë testimin e **njehsorëve** sipas planit të rregullt, ad-hoc ose sipas kërkesës së bërë nga ana e **konsumatorit** (ky testim nuk mund të bëhet më shpesh se një herë në 2 (dy) vite për njehsorët direkt. Për çdo kërkesë nga ana e **konsumatorit** në afatin më të shkurtër, shpenzimet e testimit do të barten nga ana e tij.

3.9.2 **OSSH** e Licencuar duhet të ketë pajisje të përshtatshme për testim për të gjithë **njehsorët** në përdorim.

3.9.3 Pajisja portabël elektronike për testim të **njehsorëve** me burim statik të saktësisë cl 0.2 duhet të jenë në dispozicion për testime. **Pajisjet portabël** të referuara më lartë të klasës cl 0.2 (mund të përdoren edhe ato me cl 0.1) që përdoren për testime, duhet të testohen dhe të kalibrohen kohë pas kohe duke përdorur



etalonëelektronik me klasë më të lartë sipas rregullave, ose tëpaktën të atestohen me pajisjet me cl 0.05 të kalibruara.

3.9.4 Testimi i **sistemeve matëse** dhe **njehsorëve** duhet të bëhet në mënyrë periodike sipas kësaj tablele:

Nr.	Tipi i Njehsorit	Periudha Minimale për Testim
1	Njehsorët indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR dhe TMT	Së paku 1 (një) herë në vit ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër.
2	Njehsorët gjysmë-indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR	Së paku 1 (një) herë në dy vite ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër.
3	Njehsorët Njëfazorë dhe Trefazorë të Tensionit të Ulët – lidhje direkte	Së paku një herë në 8 (tetë) vite ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër.

3.9.5 Testimi nga OSSHnë prezencë të përfaqësuesit të **konsumatorit** kurdo që është e mundur posaçërisht për **Njehsorët** e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose varësisht nga rasti që paraqitet.

3.9.6 Me rastin e ndonjë kërkesë nga ana e **konsumatorit**, **njehsori/ pajisjet matëse** duhet të testohen me anën e pajisjeve adekuate sipas rregullave të këtij Kodi dhe proceduraveqë rrjedhin nga **OSSH** sipas mundësisë në prezencë të konsumatorit apo përfaqësuesittë tij.



3.9.7 **OSSH** duhet të mbajë regjistrin e të gjithë **njehsorëve** që tregojnë numrin serik të tyre, vendndodhjen, numrin e plombimit, datën e testimit, gabimin e shfaqur gjatë kohës së testimit, vlerën e saktësisë, ashtu që të mundësoj kontrollimin e mundshëm në ndonjë periudhë të kërkuar kohore të përcaktuar sipas **Rregullatorit** dhe standardeve ndërkombëtare për energji elektrike.

3.9.8 Periudha kohore sipas Udhëzimit Administrativ UA 02-15, për verifikimin e rregullt të pajisjeve matëse:

1. 8 vite për njehsorët elektronik të energjisë elektrike njëfazorë dhe shumëfazorë të rrymës alternative të lidhur drejtpërdrejt;
2. 6 vite për njehsorët elektronik të energjisë elektrike njëfazorë dhe shumëfazorë të rrymës alternative të lidhur përmes transformatorëve matës;
3. 12 vite për njehsorët induktiv njëfazorë dhe shumë fazorë të energjisë elektrike të rrymës alternative të kyçur drejtpërdrejt;
4. 6 vite për njehsorët induktiv njëfazorë dhe shumë fazorë të energjisë elektrike të rrymës alternative të kyçur përmes transformatorëve matës;

3.9.9 Verifikimi i saktësisë matëse të TMRR dhe TMT preferohet pas periodës prej 12 vitesh.

3.10. Plombimi i Pajisjeve Matëse

OSSH mund të vendos dy ose më shumë plomba në çdo **njehsorë**, ndërprerës, në maksigraf (në reset) dhe aparatura tjera... Në raste të veçanta, sipas Ligjit për Energjinë Elektrike në fuqime kërkesë nga konsumatori dhe në llogari të tij mund të instalohet pajisja shtesë kontrolluese për matjen e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike

3.10.1. **Njehsorët**, terminalët e **njehsorëve**, kutitë e **njehsorëve**, kthinat matëse, terminalët në sekondar të **TMRR-ve** dhe të **TMT-ve**, terminalët ku bëhet testimi etj., duhet të sigurohen me etiketa plastike të qarta dhe të lexueshme, ashtu që të



tregojnë numrin që e kanë, shenjën e identifikimit të **OSSH**-së dhe të jenë të lidhura me tel jo-korrodues të çeliktë.

- 3.10.2. OSSHeshte** përgjegjëse për kontrollimin dhe mirëmbajene pllombave, dhe pajisjeve për plumbim, duke mbajtur regjistrin e pajisjeve të plumbimit, regjistrin për personat e autorizuar që i kanë këto pajisje dhe vendosjen e tyre.
- 3.10.3.** Nëse personi i autorizuar i **OSSH**-së së Licencuar apo konsumatorie gjen ose vërteton se plomba është e prekur ose e shkatërruar, atëherë ai duhet që sa më parë të njoftojë organin përgjegjës për plumbim si dhe palën ku është gjetur plomba e dëmtuar
- 3.10.4. OSSH,** përkatësisht personi i autorizuar për plumbim, pasi që e merr njoftimin duhet brenda 7 ditëve të zëvendësojë plumbën e dëmtuar.
- 3.10.5.** Atëherë kur shihet se pajisja matëse nuk i plotëson kriteret për matje të sigurt (pajisja matëse ku është dëmtuar plomba), **OSSH** duhet që të bëjë zëvendësimin e pajisjeve matëse, ndërsa për ekzistuesen duhet të bëhet testimi dhe kalibrimi i nevojshëm ashtu siç kërkohet me **Kodin e Matjes** dhe procedurave të OSSH-së aprovuar nga **Rregullatori**.



4. Evidentimi dhe Operimi me Pikën Matëse

4.1 Leximi i Njehsorit, Grumbullimi dhe Shkarkimi i të Dhënave në Data Bazë

4.1.1 OSSh do të aranzhojë leximin e **njehsorëve** të kategorive të ndryshme nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar në varshmëri nga kategoria e **konsumatorit**. **Njehsorë**tapotë dhënat e regjistruara mund të lexohen në mënyrë manuale ose duke përdorur pajisje për lexim nëpërmjet portës optike të **njehsorit**,apopajisjes që lexon nga largësia e kryer nga përfaqësuesi i **OSSH-së**.

4.1.2 Atëherë kur është instaluar **njehsorielektronik** për **konsumatorët** dhe **Prodhuesit**, **OSSH-së** duhet t'i kërkohej që të mbajë databazën e matjeve të **njehsorit** për **konsumatorin** ose **gjeneratorin** për:

- a) 12muajhistorinë e të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjet e njehsorëve për faturim (të dhënat një herë në muaj); dhe
- b) 5 vjet në arkiv.

4.2 E drejta për Qasje në të Dhënat e Njehsorit

4.2.1 Personat që kanë të drejtë qasjeje në të dhënat e **njehsorit** janë:

- a) **OSSH**, që është përgjegjëse për instalimin e **njehsorëve**;
- b) **Qendra e Kontrollit të OSSh-së**;
- c) **Operatori i Transmetimit** nëse të dhënat e tilla janë të nevojshme për qëllime të planifikimit të **Sistemit të Transmetimit**;
- d) **Konsumatori** i energjisë elektrike ose **Prodhuesii** Energjisë Elektrikespektivisht Shfrytëzuesi/Pronarii **njehsorëve**, ashtu siç e kërkon rasti dhe deri në nivelin e duhur të lejuar;
- e) Çdo person tjetër që për kohën në fjalë ka marrëveshje që të bëjë furnizimin me energji elektrike tek **konsumatorët**. Në bazë të klauzolës (e), personi duhet të paraqesë autorizimin në formë të shkruar nga **konsumatori** tek **OSSH**; dhe
- f) Personeli i autorizuari, por vetëm atëherë kur një informatë e tillë kërkohej për çështjet në lidhje me kontrollimet dhe **shqyrtimet**.



4.3 Operimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit të Njehsorëve Matës

4.3.1. Operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të njehsorëve matës duhet të jetë ekskluzivitet i OSSH-së.

4.3.2. Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e **TMRR**, **TMT** dhe **njehsorëve** tjerë, instalimin e përçuesve, terminalet, shtrirjen e mirëfilltë të kabllave, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të **njehsorëve**, gjendjen e plombave, leximin të rregullt të **njehsorëve** dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim apo nga **Qendra Grumbulluese e të Dhënave**, si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të **njehsorëve matës**.

4.4 Dispozitat Kryesore të Kodit të Matjes përgjatë Furnizimit të Konsumatorëve me Energji Elektrike

4.4.1 Duke pasur parasysh përgjegjësitë për furnizimin me energji elektrike të **konsumatorëve** të ndryshëm dhe procedurave tjera, veçohen dispozitat në aspektin e obligimeve ndaj pikës matëse si në vijim:

- leximin e **njehsorëve matës** të energjisë elektrike;
- vlerësimin e konsumimit në rastin kur ka prishje dhe ndërprerje në furnizim;
- plumbimin e **njehsorëve**;
- qasjen në pronat e **konsumatorëve** që furnizohen me energji elektrike për leximin e **njehsorëve**, inspektimin dhe testimin e **njehsorëve matës** të energjisë elektrike; dhe testimet Laboratorike dhe vulosja e tyre nga Ministria përgjegjëse sipas periodave të përcaktuara nga Udhëzimet Administrative.

4.5 Zëvendësimi i Njehsorëve të prishur dhe atyre që duhet të kalibrohen



4.5.1 OSSh duhet të ketë në inventarin e **tijnjehsorë** rezervë në sasi të mjaftueshme, për zëvendësime të mundshme, për **njehsorët** që duhet të kalibrohen, që nuk punojnë si dhe për ata që mund të prishen.

4.5.2 Normat e inventarit për **njehsorët** rezervë duhet të mbahen në çdo Distrikt. Duhet të merret parasysh krahasimi i numrit të **njehsorëve** që gjenden në servisim dhe kalibrim dhe atyre që mund të prishen, si dhe shfrytëzimin e statistikave për ndërrim të njehsorëve në këtë aspekt.

4.6 Mekanizmat për Zgjidhjen eMosmarrëveshjeve

4.6.1 Mosmarrëveshja e mundshme mes **OSSh-së** dhe **konsumatorëve** duhet të zgjidhet në bazë të marrëveshjes të bazuar në Ligjin mbi Energjinë Elektrikenë fuqi, si dhe sipas Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ne sektorin e energjisë, të nxjerrë dhe aprovuar nga **Rregullatori**.

4.6.2 Çdo mosmarrëveshje në mes të **Shfrytëzuesve** dhe **OSSh-së** që ka lidhje me **njehsorët matës** dhe metodat matëse zgjidhen në bazë të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ne sektorin energjisë, bazuar në dispozitat **e këtij Kodi dhe Kodit tëShpërndarjes**

4.6.3 Çdo mosmarrëveshje në mes të **OST-së** dhe **OSSh-së** për metodat e matjes dhe në lidhje me **njehsorët matës**, në pikat e shkëmbimit duhet të zgjidhet në bazë të dispozitave të **Kodit të Matjeve të OST-së** dhe **KodevetëRrjetit** dhe të **Shpërndarjes**. Në rast se nuk mund të gjendet zgjidhje adekuate atëherë do të konsultohet Komisioni përkatës dhe **Rregullatori**.

4.7 Njehsorët Special

4.7.1 Njehsorët me parapagimpër pagesën e energjisë elektrike mund të vendosen nga **OSSh-ja** e Licencuar në vend të **njehsorëve** konvencional nëse është e



nevojshme dhe e domosdoshme. Me parapagim nënkupton që **konsumatorët** paguajnë energjinë elektrike para se ta harxhojnë atë.

4.7.2 Njehsorët tarifor do të vendosen dhe mund të vendosen atëherë kur, **Rregullatori** vendos për metodat matëse të energjisë elektrike dhe udhëzimeve që ky organ i përcakton.

4.7.3 Njehsori që shërben për matjen e energjisë së **eksportuar/importuar** që **konsumatori** me mundësi të prodhimit të energjisë elektrike (me gaz, turbinat e erës dhe ata me prodhim të celulave fotovoltike etj.) mund ta eksportojnë energjinë e tepruar.

4.8 Njehsorët Matës për Konsumatorët e TL, TM dhe TU me Matje Multifunksional

4.8.1 Njehsorët dhe pajisjet matëse për trafostacionet dhe nën-trafostacionet ndërlidhëse OST me **OSSH** që furnizon me nivel tensioni mbi 35 kV (pa e përfshirë atë) duhet të instalojnë **njehsorët** dhe pajisjet gjegjëse matëse, sipas rregullave dhe kodeve të OST-së.

4.8.2 Konsumatorët që janë të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV dhe 10 (20) kV të trafostacionit, atje ku ekziston edhe niveli 6 kV duhet që të kenë **njehsorë** të veçantë në pikat dalëse të dërgesës (Furnizimeve) në drejtim të tyre.

4.8.3 Për furnizim të **konsumatorëve** 10 (20) kV tek trafostacionet që janë të montuara në shtylla, këta **njehsorë** dhe pajisje matëse duhet të montohen në panel, të jenë të dukshëm dhe të përshtatshëm për lexim. Këta **konsumatorë** konsiderohen si **konsumatorë** 0.4 kV. Të gjithë **konsumatorët** e tillë duhet të sigurojnë qasje të veçantë dhe pa asnjë problem tek **njehsorët**, për punëtorët e autorizuar të **OSSH-së**.



- 4.8.4 Transformatorët Matës të Rrymës (TMRR)** që përdoren për matje (e qe) janë vetëm të një herësi, që shërbejnë vetëm për matjen e energjisë elektrike. Ky herës duhet të zgjidhet bazuar në standardet internacionale që aplikohen në BE, përjashtim bëhet te trafostacionet e TM të OSSH-së ku mirëmbajtja dhe mbikëqyrja është e drejtë e vetme e OSSH-së.
- 4.8.5** Derisa e zgjedhim raportin e herësit për **TMRR**, ngarkesa maksimale duhet të merret 80% e ngarkesës maksimale të kontraktuar ose 100% e ngarkesës maksimale të regjistruar (për konsumatorët ekzistues).
- 4.8.6** Sektorët përkatëse të **OSSH**-së duhet të kontrolloj raportin e herësit të **TMRR**-ve çdo vit ose atëherë kur kërkohet rritje e kërkesës nga ana e **konsumatorit**.
- 4.8.7** Për **konsumatorët** që pikën matëse e kanë të vendosur në nivelin 10 kV, kabineti ku vendosen pajisjet matëse duke përfshirë **TMRR** dhe **TMT**si tërësi njësi mund të vendoset në pronën e konsumatorit me qasje të përhershme të OSSH-ës. Kjo lidhje duhet të realizohet në pajtueshmëri me rregullat e caktuara të **OSSH**-së.
- 4.8.8** Për **konsumatorët** që furnizohen me nivel tensioni 35 kV, me pikë matëse të këtij niveli, duhet të bëhet një realizim i njëjtë i lidhjes si në pikën 4.8.7.
- 4.8.9** **TMRR**-tnë qarkun sekondar duhet të sigurohet që në asnjë rrethanë të mos jetë i hapur Shkarkuesit e mbitensionit duhet të vendosen para pikës matëse
- 4.8.10** Lidhjet e **TMRR**-ve dhe **TMT**-ve në te Konsumatorët e **TM (Tensionit të Mesëm)** 35,10(20 kV) duhet të realizohet ashtu që:
- (a) Me kablllo me mbështjellës të çeliktë do të realizohet lidhja e **TMRR** dhe **TMT**si një tërësi e pandërprerë deri te kutia e Panelit të **njehsorëve matës**.



- (b) Nëse përdoret kabli jo i çeliktë atëherë ai kabëll duhet të futet në gypa (tuba të përcaktuar sipas standardeve përkatëse) dhe nuk duhet të futen drejtë për së drejti nën dhe apo kanal kabllovik.
- (c) Aty ku kryhet lidhja e kabllit me kutitë e **TMRR**-ve dhe **TMT**-ve si njësi (për secilin) si dhe e kutisë së **njehsorëve matës** duhet të realizohet me shtrëngues metalik si dhe me dadot siguruese dhe që gjithsesi duhet të mbyllen me material epoksid ose mbështjellës tkurrës termoplastik.
- (d) Pjesa e çeliktë e mbështjellësit të kabllit duhet të përtokëzohet nëpërmjet shtrënguesit të metaltë ashtu siç është cekur më lartë.
- (e) Gjatësia e preferuar e mbështjellësve tkurrës termoplastik ose të ndonjë materiali tjetër duhet të jetë së paku 1.5 m nga terminali i lidhjes të **TMRR**-së ose **TMT**- së.
- (f) Të gjithë **TMRR**-të ose **TMT**-të si dhe **njehsorët matës** preferohet të jenë afër njëri tjetrit.

4.8.11 Lokacioni i **njehsorëve matës** të **TM (Tensionit të Mesëm)** duhet të jetë në distancë të arsyeshme nga pika e hyrjes në pronën e **konsumatorit** ashtu që personi i autorizuar i **OSSH**-së mund të ketë qasje tek **njehsorët matës** pa kërkuar asistencë nga personeli i autorizuar i **konsumatorit** të **TM**. Lokacioni duhet të ketë pamje të qartë nga jashtë pronës së **konsumatorit**. Kutia ku vendosen pajisjet matëse duhet të jetë e izoluar nga ndikimi i lagështisë dhe kushtet tjera atmosferike të përcaktuara sipas standardeve **IEC**përkatëse.

4.8.12 **OSSH** duhet të sigurojë të gjithë **njehsorët matës** për të gjitha lidhjet e **TM**. Në kushte të veçanta atëherë kur kjo mundësi lidhjeje nuk ekziston, atëherë në anën e **TU (Tensionit të Ulët)** duhet të vendosen Pajisjet Matëse dhe duhet që sa më shpejtë që është e mundur të zëvendësohen këto lidhje me ato në anën e **TM**-së.

4.8.13 Kur ekziston lidhje e pajisjeve matëse vetëm në anën e **TU**, ndërsa konsumatori ka faturim në grupin tariforë të **TM** sipas marrëveshjes për kyçje, **OSSH** duhet që **konsumatorin** ta ngarkojë me humbjet që shkaktohen si pasojë e humbjeve në



Transformatorë ose ta ndërrojëmarrëveshjen për kyçje dhe faturimi të kalohet në TU (në harmoni me konsumatorin).

4.8.14 Konsumatori ka të drejtë të përzgjedhë grupin tarifor të faturimit nëse plotësohen kushtet e parashtruara në **Kodin e shpërndarjes** dhe në Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të OSSH-së, aprovuar nga **Rregullatori**.

4.8.15 Pika matëse për konsumatorët e tensionit të ulët, me matje gjysmë-indirekte multifunkionale duhet të zhvillohet njësoj si te udhëzimet për pikat matëse të TM me një ndryshim që TMT-të nuk ekzistojnë, ndërsa vendi i marrjessë tensioneve për pikë matëse duhet të mbulohet (mbështjellje izoluese atmosferike termike) me material termotkurrës termoplastik. Te rastet kur pika matëse me TMRR dhe njehsorët vendoset në një orman të veçantë bëhet pllombimi i ormanit.

4.9 Procedurat e Matjes për Konsumatorët e TU me matje Direkte

4.9.1 Konsumatorët e tensionit të ulët sipas mënyrës së shpenzimit të energjisë elektrike dhe veprimtarisë së tyre, ndahen në disa grupe tarifore të ndryshme e që mund të jenë komercial me matje direkte, amvisëri, institucione, ndriçim publik etj., por që në aspektin e matjes dhe kompletimit të pikës matëse paraqesin të njëjtën mënyrë të trajtimit.

4.9.2 Pajisjet matëse duhet të vendosen jashtë pronës së **konsumatorëve**, në vend të përshtatshëm si dhe në kuti (orman) që duhet të mbyllet.

4.9.3 Pika e vendosjes së **njehsorit matës** të energjisë elektrike duhet të mundësoj qasje për lexim, për inspektim dhe **mirëmbajtje**. Pajisja matëse duhet jetë e përshtatshme për inspektim dhe për mirëmbajtje që do të bëhet nga ana e personit të autorizuar nga **OSSH**.

4.9.4 Kutia e pajisjes matëse për energji elektrike duhet të jetë e plumbuar me dy plomba që do të pamundësoj çdo ndërhyrje si nga ana e **konsumatorit** ashtu edhe nga ana e personit që e bënë leximin e **njehsorit** i autorizuar nga ana e **OSSH-së**.



- 4.9.5 Brenda kutisë së **njehsorit matës** nuk duhet të ketë siguresa apo lidhëse serike, para **njehsorit matës**, ashtu që personeli i paautorizuar dhe **konsumatori** mos të ketë mundësi qasjeje para **njehsorit matës**. Për rastet e domosdoshme dhe kur posedohet Ormani Kryesor Kyçës (OKK ose KPO – siç emërtohet zakonisht) duhet të jenë të ndërtuara ashtu që të mbyllen asisoj që të pamundësohet qasja dhe pllombohen nga ana e OSSH-së.
- 4.9.6 Linja furnizuese deri te kutia ku janë të vendosur **njehsorët** dhe pajisjet matëse duhet të jetë e realizuar nëpërmjet të kabllave adekuate të specifikuara sipas standardeve teknike dhe e pa ndërprerë, vazhduar apo dëmtuar gjatëgjithë trasesë së saj (përveç lidhjeve të jashtme të dukshme në konzolla apo të ngjashme me qasje të kufizuar).
- 4.9.7 Atëherë kur furnizimi i **konsumatorëve** bëhet nëpërmjet të kabllave nëntokësorë, nuk duhet që të ketë ndërprerje, lidhje "T" në mes të këtyre kabllave dhe të OKK apo kutisë ku janë të vendosur **njehsorët** dhe pajisjet matëse të energjisë elektrike.
- 4.9.8 Të gjitha lidhjet duhet të jenë të realizuara nëpërmjet konektorëve në terminalin e **njehsorëve**.
- 4.9.9 Çdo ndërprerës për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike duhet të vendoset pas **njehsorëve**.

4.9.10 Procedurat e Matjes për Konsumatorët e ndryshëm në Objektet Banesore

- a) Paneli i **njehsorëvematës** në ndërtesat shumëkatëshe duhet të vendoset kryesisht në katin përdhësë dhe do të përcaktohet gjatë fazës së dhënies së kushteve teknike të kyçjes dhe **projektimit** me aprovimin e OSSH-së duke qenë në vendin ku ka qasje të lehtë për lexim, monitorim dhe **mirëmbajtje** për personelin e autorizuar nga **OSSH**.



b) Ndërtesat shumëkatëshe duhet të kenë **njehsorin** për matjen e energjisë totale, për të gjithë objektet në trafo-regjionin përkatës me lexim në distancësi dhe **njehsorët** për çdo **konsumatorë** veç e veç.

c) Përtokëzimi duhet të bëhet për tërë panelin ashtu siç kërkohet nga standardet relevante ndërkombëtare dhe rregullave teknike. d) Konsumatorët në këto objekte janë të të gjitha kategorive në TU; Amvisëri, komercial etj.

4.10 Tërësia e Pikës Matëse

4.10.1 Gjatë përshkrimit të kushteve teknike të kycjes, do të përcaktohet vendi dhe lloji i matjes si dhe specifikat tjera teknike sipas **Kodit të Matjes** dhe **Kodit të Shpërndarjes** dhe rregullave e standardeve në fuqi. Aplikimi i detajeve tjera teknike është përshkruar në rregulloret teknike, standardet teknike (IEC), udhëzimet, rekomandimet, rekomandimet e prodhuesve etj.

4.10.2 **OSSH** bazuar në Ligjet për energji dhe energji elektrike, kodet, standardet dhe rregullat tjera në fuqi, do të krijojë procedurat mbi mënyrën e qasjes, mirëmbajtjen, përcjelljen dhe kontrollin e të gjitha pikave matëse në tërë territorin e Kosovës.

4.11 Pasaktësia e Matjes

4.11.1 Pasaktësia e matjes ka kuptimin kur ndonjë element matës ka defekt elektrik/fizik të tij dhe si rezultat kufiri i saktësisë së matjes mund të jetë vlerë e përcaktuar apo e papërcaktuar. Në rastin e përcaktimit të pasaktësisë në matje, e cila nënkupton pasaktësinë e vetë njehsorit apo edhe në tërësi të sistemit matës apo ndonjë elementi të tij (pasaktësia nënkupton edhe lidhjen jo adekuate të sistemeve matëse të rrymave dhe tensioneve si në aspektin e drejtimit ashtu edhe të fazave perkatëse), pas testimit të pajisjeve matëse dhe/apo përcaktimit të pasaktësisë së sistemit matës apo ndonjë elementi të tij në formë empirike ose testimit të tij dhe pasi që të vërtetohet kufiri i pasaktësisë, përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të **pajisjeve matëse** dhe/apo definimit të përqindjes së pasaktësisë së



sistemit matës apo ndonjë elementi te tij. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë të klasës së saktësisë (p.sh. për **njehsorët** e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0, kufiri i lejuar do të ishte 6.0%) atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë)muajt e fundit për konsumator jo shtëpiak përkatësisht 6(gjashtë) muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak, sipas vlerës se përcaktuar te gabimit.

Gjithashtu edhe ne rastet kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në matje mes njehsorit kontrollues dhe njehsorit kryesor është më shumë se $\pm 5\%$, atëherë veprohet sipas kësaj pike.

4.11.2 Ne rastin e pamundësisë se përcaktimit te pasaktësisënë sistemin matës apo kur aika gabuar 100 %(nuk ka regjistruar fare), atëherë korigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares adekuate të shpenzimit të konsumatorit. Gjatë kalkulimit të korigjimit duhet zbritur shpenzimet e regjistruara per periudhën kontestuese me sistemin matës gjatë kohës në defekt (larguar nga matja) dhe shtuar mesatarja adekuate.



5. Emërtimet e shfrytëzuara në Kodin e Matjes së OSSh-së

5.1.1. Terminologjia e përdorur është sipas ligjeve në fuqi, terminologjisë së përdorur në **Kodine Shpërndarjes** dhe me të gjitha procedurat e **OSSH-së**.

5.1.2. Disa nga termat nuk janë aplikuar në këtë dokument, mirëpo do të kenë aplikim në procedurat dhe specifikimet teknike të bazuara në këtë Kod.

Termi	Përcaktimi
AC	Rryma/Tensioni Alternative
Aplikantët e Sistemit të Shpërndarjes	Person juridik, Shfrytëzues aktual ose i ardhshëm i Sistemit të Shpërndarjes , që aplikon për leje për t'u kyçur ose për të modifikuar lidhjen ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes .
Aplikimet për lidhje në Sistemin Shpërndarjes	Dokumente të plotësuara nga Përdoruesit e perspektivës, që e kërkojnë qasje për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes , ose nga Shfrytëzuesit ekzistues për të modifikuar kyçjen ekzistuese. Me qëllim që të marrë miratimin e OSSH-së për kyçje, dokumentet përgatiten sipas dispozitave të këtij Kodi.
AKS	Agjensioni Kosovar i Standardizimit në kuadër të Ministrisë përgjegjëse
AMK	Agjensioni i Metrologjisë së Kosovës
DC	Rryma/Tensioni Njëkahore
Defektet	Defekti është një fenomen, që ndodhë për shkak të arsyeve të brendshme dhe të jashtme dhe shkakton deformimin e parametrave të energjisë elektrike ose ndërprerjen e funksionimit për një periudhë të caktuar kohe, të një ose më shumë elementeve, që nga ana tjetër çojnë në ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.
Demarkacioni (Hapesira e lire)	Kufijtë e lejuar të lëvizjes së personave në objektet elektroenergjetike



Diagrami i ngarkesës	Progresi (Rrjedhja e ngarkesë) i ngarkesës gjatë çdo ore (00 – 24 orë) për një ditë, ose një periudhë tjetër (15 min) për një konsumatorë, drejtim apo stabiliment etj.
Energjia elektrike aktive	Energjia Elektrike Aktive (kWh dhe shumëfishet e saj) është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, duke qenë integrali i caktuar i fuqisë aktive me kufij kohor.
Energjia e Dukshme	Energjia e Dukshme nënkupton integralin e Fuqisë së Dukshme në respekt (Vareshmeri) të kohës, e matur me VAh dhe shumëfishët e tij.
Energjia Elektrike Reaktive	Energjia Elektrike reaktive (kVArh dhe shumëfishet e saj) është integrali i caktuar me kufij kohor i fuqisë reaktive .
Faktori i Fuqisë	Raporti i fuqisë elektrike aktive (W) me fuqinë elektrike të dukshme (VA) (cosφ). Vlera minimale e lejuar ecosφ është 0.95.
Frekuenca Nominale	Numri i periodave të rrymës alternative për sekondë e shprehur në Hz. Frekuenca në të cilën operon normalisht sistemi është 50 Hz.
Fuqia e Instaluar e Prodhuesit Elektrik	Kapaciteti nominal i fuqisë aktive që mund të japë një Prodhuesi Energjisë Elektrike pa ndërprerje, bazuar mbi dokumentacionin e prodhuesit (certifikatën e prodhuesit), i cili është shkruar në etiketën përkatëse të prodhuesit.
Fuqia Elektrike Aktive	Produkti i tensionit, rrymës dhe kosinuit të këndit ndërmjet tyre. $P=(U \times I) \times \cos\phi$ ose shkalla(madhësia) me të cilën transferohet energjia në (kW dhe shumëfishet e saj).
Fuqia Elektrike Reaktive	Produkti i tensionit, rrymës dhe sinusit të këndit të fazës ndërmjet tyre. $Q=(U \times I) \times \sin\phi$ në (kVAr dhe shumëfishet e saj)
Fuqia Maksimale e Gjeneratorit Elektrik	Maksimumi i mundshëm i fuqisë, që është në gjendje të japë Prodhuesii Energjisë Elektrike në kushte të caktuara mekanike dhe elektrike të tij.



Fuqia e Dukshme	Fuqia e Dukshme paraqet prodhimin e vlerave efektive të rrymës dhe tensionit. Për qarqet e sistemeve AC paraqet rrënjën katrore të katrorëve të fuqisë aktive dhe reaktive dhe e matur me kVA dhe shumëfishëve të tij.
Furnizuesi	Ndërmarrje e energjisë e licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit
Prodhues	Një person fizik ose juridik që prodhon energji elektrike.
Prodhues i Pavarur	Personi apo kompania e cila gjeneron energji elektrike përfshirë edhe konsumatorët me Vet-Prodhues, të cilët janë direkt të kyçur në Sistemin e Shpërndarjes së OSSh-së.
Prodhues Elektrik	Një tërësi godinash me disa pajisje mekanike dhe elektroenergjetike të caktuara, të cilat kanë si destinacion bazë prodhimine Energjisë Elektrike.
Prodhues i Lidhur në Sist. Shpërndarës	Gjenerator Elektrik me njësi gjenerimi të lidhur direkt në Rrjetin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
Harmonikët	Rryma (Tensionet) sinusoidale me frekuencë të njëjtë dhe me shumëfishat numerik të frekuencës nominale.
Humbjet Teknike të Energjisë	Humbjet teknike e Energjisë Elektrike në një Stabilimentet elektrike paraqet diferencën mes Energjisë Elektrike hyrëse në element dhe Energjisë Elektrike që del nga ato stabilimente
I izoluar	Procesi i ndarjes fizike të pjesës pa tension nga ajo me tension
IEC	Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar (International Electrotechnical Commission)
Injektimi nga Rrjeti i Transmetimit	Kalimi (Furnizimi) i Energjisë Elektrike në Sistemin e Shpërndarjes nga Sistemi i Transmetimit në pikat e kyçjes midis tyre.
Kalibrim	Përveç kuptimit të centrit të njehsorit në vlerën e kërkuar, ky emërtim shfrytëzohet edhe në kuptimin e certifikimit teknik të



njehsorit, i cili përmbush standardin për vulosjen me pllomba shtetërore të tij.

Kërkesa (konsumi)	Nëse nuk jepet ndryshe, kërkesa e shprehur në MW ose MVAr e Energjisë Elektrike Aktive dhe Reaktive.
Kërkesa Maksimale	Kërkesë Maksimale, do të thotë vlerë maksimale të kVA e tërhequr në pikën matëse të furnizimit të konsumatorit në pronë të tij, gjatë çdo periudhe kohore prej 15 minutash, ashtu siç është përcaktuar nga Rregullatori .
Kërkesa Maksimale e Njëkohshme	Për një periudhë të caktuar kohore, shuma e të gjitha kërkesave individuale për gjatë tërë pikave shkëmbyese në sistemin shpërndarës(SSh) jep si rezultat kërkesën e njëkohshme të OSSH -së. Për një muaj (30 ditë kjo do të llogaritet për intervale kohore prej 15 minutash si: $4 \times 24 \times 30 = 2880$ periudha).
Kodi i Shpërndarjes	Është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimeve të OSSH -së për Shfrytëzuesit dhe Konsumatorët .
Kodi i Matjes	Nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lidhur me matjen e energjisë elektrike.
KQKO	Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale
Konsumatori (tarifor)	fundor Konsumatori i energjisë elektrike që blen energji elektrike për përdorim vetanak.
Konsumatori prodhues	Vet- Është konsumatori i energjisë elektrike që në të njëjtën kohë dhe të njëjtin lokacion është pronar i mikro-gjeneratorit të BRE-ve, të kyçur në rrjet dhe me të drejtë të vetë-konsumit të energjisë elektrike të gjeneruar si dhe dërgimin e tepricës së energjisë elektrike të gjeneruar tek furnizuesi.



Kufijtë e Pronësisë	Kufijtë mes Sistemit të Shpërndarjes dhe pajisjeve në pronësi të Shfrytëzuesit .
Kushtet e Ngjarjes	Kushte operimi për një pajisje, instalim të veçantë elektrik me një ose me shumë defekte që dëmtojnë operimin e Sistemit të shpërndarjes ose ndërpresin furnizimin me energji elektrike.
Kushtet Teknike për Kyçje	Kerkesat teknike në kuadër të Pëlqimit Energjetik të lëshuar nga OSSH që lejon lidhjen e objekteve elektrike të Aplikantit, me Sistemin e Shpërndarjes
KVA	KiloVolt-Ampër
Kyçja	Kyçja mes dy objekteve/sistemeve apo Shfrytëzuesit të Sistemit të Shpërndarjes .
Licencë	Është definuar si në Ligjin Për Energjinë Elektrike në fuqidihe në Rregullin mbi Licencimin e aktiviteteve Energjetike në Kosovë.
Ligji i Energjisë Elektrike	Është ligji aktual për energji elektrike, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës
Lidhja e shkurtë	Lidhja e shkurtë është ndodhia për shkak të dëmtimeve të ndryshme ose veprimeve të gabuara që lidhin elementet mes dy pikave me potenciale të ndryshme.
Luhatja (Oscilimi)	Perceptimi në mënyrë vizuale, i krijuar nga një luhatje e lehtë që reflektohet në ndriçim ose shpërndarja spektrale e të cilit luhatet me kalimin e kohës.
Luhatjet e Tensionit	Një seri ndryshimesh të shpejta tensionit, që mund të jenë të rregullta ose të çrregullta.
Matja Tarifore	Sistemi i matjes së energjisë elektrike që përbëhet prej pajisjeve matëse dhe pajisjeve për grumbullimin e të dhënave, në bazë të të cilave furnizuesi i energjisë elektrike bënë llogaritjen.
Marrëveshja e Kyçjes	Një marrëveshje dypalëshe në mes OSSH-së dhe çdo Shfrytëzuesi të Sistemit të Shpërndarjes , që përmban tërësinë e kushteve për kyçje në Sistemin e Shpërndarjes .



Mbrojtja		Masa për parandalimin e kushteve jo normale në Sistemin Elektroenergjetik , zbulimin e defekteve dhe aktivizimin e alarmeve dhe dhënieve të sinjaleve, deri në shkëputjen e elementit të defektuar.
Mbrojtja ndihmëse (back – up) (Mbrojtja Rezervë)		Sistemi mbrojtës që do të ndërpret një ndërpres ose mekanizma të tjerë që ndërpresin rrymën e lidhjes së shkurtë , në mungesë të operimit të mbrojtjes, të një sistemi tjetër mbrojtje.
Mirëmbajtja		Procesi i gjithë veprimeve teknike dhe organizative të kryera për elementet e Sistemit Elektroenergjetik gjatë periudhës së mirëmbajtjes me qëllim që të rikuperohen aftësitë e tyre përforcuese për funksionet e planifikuara.
Ndarësi		Një mekanizëm që siguron në pozicion të hapur një shkëputje të dukshme të një qarku elektrik .
Ndërprerjet Planifikuara	e	Janë ndërprerjet e furnizimit me Energji Elektrike për shkak të mungesës së gjenerimit, mbingarkesës së elementeve të Sistemit Elektroenergjetik (përveçse kur është ndërprerje e detyruar) si dhe ndërprerjet për mirëmbajtjet e planifikuara.
Ndërprerjet për shkak të Defekteve në Sistemin El-En.		Ndërprerje e furnizimit me energji elektrike për shkak të defekteve të elementeve të Sistemit Elektroenergjetik (si linjat, transformatorët e nënstacioneve, njësitë gjeneruese, etj.).
Ndërprerësi i Qarkut		Një pajisje mekanike kyçëse/ shkyçëse, e aftë të ndërpresë rrymat në kushte normale të qarkut si dhe të përcjellë dhe të ndërpresë për një periudhë të caktuar kohe rrymën në kushte të veçanta jonormale të qarkut, si ato të qarkut të lidhjes së shkurtër.
Ngarkesa / Kërkesa (konsumi)		Ngarkesa është shkalla me të cilën energjia elektrike e shpërndarë në apo prej një sistemi apo një pjese të sistemit, e shprehur në MW dhe MVA _r (d.m.th. fuqi aktive dhe fuqi reaktive).



Piku	Maksimumi i vlerës së ngarkesës në MW, regjistruar brenda një periudhe kohore specifike.
Ngarkesa Maksimale	Ngarkesa maksimale e regjistruar, do të thotë vlera maksimale në kW e tërhequr në pikën matëse të furnizimit të konsumatorit në pronën e tij, gjatë çdo periudhe kohore prej 15 minutash ashtu siç është përcaktuar nga Rregullatori .
Ngarkesa Maksimale e Njëkohshme	Për një periudhë të caktuar kohore (një periodë 15 minutëshe), shuma e të gjitha ngarkesave individuale për gjatë tërë pikave shkëmbyese në SSh , jep si rezultat ngarkesën e njëkohshme të OSSH -së. Për një muaj (30 ditë kjo do të llogaritet për intervale kohore prej 15 minutash si: $4 \times 24 \times 30 = 2880$ periudha).
Ngarkesat e Çrregullta	Ngarkesa që kanë mundësi të krijojnë harmonikë , luhatje ose mungesë balance në sistem.
Ngjarja	Një ndodhi e paplanifikuar apo e papërcaktuar që ndodhë në Sistem, e që përfshinë përkrimin e përgjithshëm, defektet, incidentet dhe shkatërrimet.
Njësia ose pajisja gjenerale për Lexim	Nënkupton Njësinë ose pajisjen gjenerale për lexim me të gjitha pajisjet shtesë që mund të shkarkojë të dhënat nga njehsorët e ndryshëm statik AC të energjisë kur janë të ngarkuar me softuerë specifik që do të quhet programi për leximin e instrumentit matës.
Njehsori	Njehsori është pajisje për matje të energjisë aktive dy-drejtimesh, fuqisë aktive, fuqisë reaktive, fuqisë së dukshme, rrymës, tensionit, faktorit të fuqisë , frekuencës dhe çdo parametri tjetër elektrik që rrjedh nga këto matje. Njehsori , duhet të jetë në gjendje të regjistrojë parametra të ndryshëm ashtu siç kërkohen për kategori të posaçme të konsumatorëve në bazë të tarifave të aplikuara kohë pas kohe.



Njehsori Kryesor dhe Njehsori Kontrollues	Njehsori primar, i cili përdoret për qëllime të faturimit, emërohet si Njehsori Kryesor . Njehsori kontrollues përdoret si mbështetje e Njehsorit Kryesor për qëllime të faturimit, atëherë kur Njehsori Kryesor nuk mund të regjistrojë ose bëjë gabime më të mëdha se sa që janë të lejuara me standard.
Njehsorët Operativ	Pajisjet matëse si dhe pajisjet përcjellëse për matje që janë instaluar për: Qëllime operationale dhe kontrollin e sistemit; Qëllimet për Monitorimin dhe Regjistrimin manual; Vlerësimin e konsumit në trafo lokale të instaluar në anën e TM dhe TU të Transformatorit të Distribuimit 10(20)/0.4 kV dhe 35/0.4 kV.
Njësia Gjeneruese	Çdo njësi gjenerimi që prodhon Energji Elektrike
Normat	Standardet, kodet, rregullat, rekomandimet, vendimet dhe dokumente të tjera normative të vendosura me ligje, akte nën-ligjore, rregullore, urdhëresa, dokumente të tjera zyrtare dhe kontrata.
Objektet e Sektorit Elektroenergjetik	Një tërësi godinash, ndërtesash dhe pajisjesh të ndryshme të projektuara për të gjeneruar, transmetuar dhe shpërndarë Energji Elektrike.
Operatori i Tregut	Është personi juridik, i licencuar nga Rregullatori , që është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë elektrike dhe barazimin përfundimtar mes prodhuesve, furnizuesve dhe konsumatorëve.
Operimi	Një veprim i planifikuar i kryer në Sistemin e Shpërndarjes.
OSSh	Nënkupton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes sipas Ligjit Për Energjinë në fuqi.
OST	Nënkupton Operatorin e Sistemit të Transmetimit , sipas Ligjit Nr. Për Energjinë në fuqi.



Pajisja e përtokëzimit	Një pajisje e fiksuar apo portative për sigurimin e një kyçje të sigurt, në mes të një përcjellësi (përçuesi) dhe tokës.
Palët	Një prodhues, Tregtar ose palë tjetër që është shfrytëzues i Sistemit të Shpërndarjes
Përcjellja e të Dhënave të Ngarkesës	Përcjellja e të Dhënave të Ngarkesës është databazë e vlerës së ngarkesës e definuar në kW, kVAR ose kVA (me shumëfishat e tyre) për çdo interval kohor të parapërcaktuar.
Periudha e Ngarkesës	Periudhë e ngarkesës do të thotë, periudha gjatë së cilës fuqia aktive, reaktive ose e dukshme, janë integruar ashtu që të prodhojnë vlerën mesatare të ngarkesës. Për qëllime të vendosjes (marrëveshjes) çdo periudhë e ngarkesës duhet të jetë në kohëzgjatje prej 15, 30 ose 60 minutash dhe që do të fillojë nga ora 0.00 dhe në përputhje me tarifën e aplikuar.
Shfrytëzues i Sistemit të Shpërndarjes	Furnizuesi publik, Furnizuesit e pavarur, Prodhues Pavarur të lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes, Konsumatorët tarifor të lidhur direkt me rrjetin e shpërndarjes si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik që përfiton nga shërbimet e rrjetit të shpërndarjes.
Shfrytëzues Kryesor	Shfrytë kryesor janë: Prodhuesit me fuqi të instaluar mbi 100 kW të lidhur drejtpërdrejt me Sistemin e Shpërndarjes si dhe të gjithë klientët e lidhur në Sistemin e Shpërndarjes në tension të mesëm.
Pika e Kyçjes	Pika fizike në të cilën instalimet e Shfrytëzuesit të Sistemit të Shpërndarjes lidhen me Sistemin e Shpërndarjes.
Pika e Furnizimit nga Sistemi i Transmetimit	Një pikë lidhje mes Sistemit të Transmetimit dhe Sistemit të Shpërndarjes ose mes Sistemit të Transmetimit dhe një Shfrytëzues të lidhur direkt në Sistemin e Transmetimit .
Pika e Matjes	Pika e matjes është vendi fizik, ku është instaluar sistemi i matjes së energjisë elektrike dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.



Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet midis Palëve.

Pika e Përbashkët

Pika në **Sistemin e Shpërndarjes** që është elektrikisht dhe teknikisht më afër me Pikën e Lidhjes dhe nga e cila lidhen ose mund të lidhen ngarkesa të klientëve të tjerë.

Procedurat për Mosmarrëveshjet

Procedurat e përshkruara në "Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë", të aprovuar nga Rregullatori.

Prodhuesit e Pavarur të Energjisë Elektrike

Prodhuesite Energjisë Elektrike të ndarë nga Sistemi Elektroenergjetik që prodhojnë Energji Elektrike për përdorimin e tyre, ose për shitje tek klientë të veçantë ose për shitje në Sistemin Elektroenergjetik.

Protokolli

Protokolli është softueri i përdorur për shkëmbimin e informatave me pajisjet e jashtme ose pajisjeve për pikën e shkëmbimit.

Qasja në Sistemin e Shpërndarjes

E drejta e subjekteve të licencuara që **gjenerojnë** ose furnizojnë energji elektrike si dhe e drejta e konsumatorëve të energjisë elektrike të kyçen dhe të përdorin, sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet e **sistemit të shpërndarjes**.

Qendra Nacionale Dispeçerike

Qendra nga ku bëhet operimi dhe përcjellja e Sistemit Elektroenergjetik të Transmetimit të OST-së, intern dhe ekstern me Sistemet tjera jashtë Kosovës, duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative dhe parametrave të cilësisë sipas kushteve teknike.

Qendra Dispeçerike e Shpërndarjes

Qendra nga ku bëhet operimi dhe përcjellja e Sistemit Elektroenergjetik të Shpërndarjes së OSSH-së në tërë territorin e Kosovës duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative dhe parametrave të cilësisë sipas kushteve teknike.



Qendra Grumbulluese e të Dhënave	Qendra Grumbulluese e të Dhënave, është qendra e cila i grumbullon dhe i proceson të dhënat nga njehsorët matës , të energjisë elektrike për aplikime të ndryshme si p.sh. llogaritë e energjisë dhe auditimin e energjisë elektrike, pagesat e energjisë si dhe sistemin për kalkulimin e humbjeve.
RAT	Rregullimi Automatik i Tensionit
Rrjeti i Transmetimit të Energjisë Elektrike	Rrjeti i Transmetimit të Energjisë Elektrike në nivelet 110 kV, 220 kV, 400 kV që mundëson transmetimin (Bartjen) e sasive të mëdha të energjisë në distanca të largëta.
Rryma e Lidhjes së Shkurtër	Rryma që qarkullon në një qark të shkurtër në një pikë të caktuar në Sistemin Elektroenergjetik dhe që mund të shprehet me kA.
SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition)	Një shkurtesë për Kontroll, Mbikëqyrje dhe Mbledhje të Dhënash në sistemin kompjuterik në kohë reale që përdoret për të monitoruar dhe kontrolluar Sistemin e Transmetimit apo Shpërndarjes në kohë reale.
Spektori Elektroenergjetik	Bashkësia e aktiviteteve të planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes për instalimin e centraleve të Gjenerimit, Transmetimit, Shpërndarjes, sistemeve/objekteve të Furnizuesit e Energjisë Elektrike dhe Linjat e Interkonekcionit për import-eksport, tranzit dhe shkëmbimet me vendet fqinje.
Shpërndarësi i Energjisë Elektrike	i Çdo person ose subjekt juridik i licencuar për shpërndarje të energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi, me një nivel tensioni më të ulët se 110 kV.
Shpërndarja	Është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen deri te konsumatori fundor.
Shqyrtimi (Komisionimi)	Procesi përfundimtar i testimit të një pjese të Sistemit të Shpërndarjes , para se ajo pjesë e Sistemit të vihet në punë.
Saktësia Përgjithshme	e Kombinimi i saktësisë së njehsorit, pajisjeve përcjellëse për transformatorët matës si dhe përcjuesit për sistemin matës.



Sistemi i Shpërndarjes	Sistemi i Shpërndarjes në nënstacionet 220/35/20/10 kV, 110/35/20/10 kV përfshinë: të gjitha kthinat dalëse 35 kV dhe 10(20) kV, (përveç kthinës transformatorike të TM dhe të shpenzimit vetanak nga zbarrat), pajisjet kyçëse/shkyçëse si dhe të gjithë elementet përcjellëse ndarëse, përtokëzuese, matëse e mbrojtëse në nivel tensioni më të ulët dhe TM në pronësi të OSSh-së. Gjithashtu të gjitha elementet e sistemit të tensionit të mesëm dhe të ulët (35 kV, 10(20) kV, 6.3 kV dhe 0.4 kV me transformimet përkatëse) deri te pika matëse (PM) e konsumatorit apo prodhuesit, përfshirë edhe PM
Sistemi i Transmetimit	Rrjeti i energjisë elektrike në zotërim të OSTT.
Sistemi Bazik Kompjuterik	Sistemi Bazik Kompjuterik nënkupton përdorimin e të dhënave që shkarkohen nga njehsorët matës nëpërmjet të Qendrës Grumbulluese të të Dhënave ose nëpërmjet rrjetës komunikuese nga largësia dhe i shkarkon në Formate Standarde që më vonë përdoren për kalkulime, analizë dhe paraqitje të ndryshme
Sistemi i Matjes (Grupi Matës – GM)	Sistemi i matjes nënkupton njehsorët , transformatorët (TMRR ose TMT), pajisjet mbrojtëse të njehsorëve duke përfshirë alarmet si dhe grumbulluesit e të dhënave, përcuesit që janë pjesë e pajisjeve matëse në pika të caktuara.
Startimi nga zero (Black Start)	Procesi i kthimit në gjendjen e mëparshme të sistemit energjetik pas një defekti të përgjithshëm apo të pjesëshëm.
Tensioni i Lartë	Tensioni në nivelin nga 110 kV e më lartë.
Tensioni i Mesëm	Tensioni në nivelin nga 35 kV deri në 1 kV.
Tensioni i Ulët	Tensioni në nivelin nën 1 kV.
Tokëzimi	Një mënyrë për të siguruar një lidhje të sigurt në mes përcjellësve dhe pajisjeve elektrike dhe tokës, nëpërmjet një pajisje tokëzimi.
TMRR dhe TMT	Nënkupton Transformatorët Matës të Rrymës (TMRR) dhe Transformatorët Matës të Tensionit .



Trafo-Stacioni (Nënstacioni) Transformues	Tërësia e stabilimenteve elektroenergjetike, funksioni i të cilave është të transformojë dhe të transferojë Energji Elektrike nga një nivel në një nivel tjetër me nivele të ndryshme tensioni.
Tregu i Energjisë Elektrike	Aranzhimet tregtare komerciale të Energjisë Elektrike në Kosovë në përputhje me Ligjin Për Energjinë në fuqi dhe Ligjin Për Energjinë Elektrike në fuqi.
Urdhri Operativ	Urdhër i detyrueshëm për njësinë pritëse që lëshohet nga Qendra Nacionale Dispeçerike ose nga Qendra Dispeçerike e Shpërndarjes sipas rregulloreve në fuqi. Urdhrat transmetohen me telefon dhe fakse ose pas instalimit të sistemit SCADA nëpërmjet mesazheve digjitale.
Veprimi Operativ	Veprime nga njësia që merr Urdhrin Operativ të nxjerrë nga Qendra Nacionale Dispeçerike ose Qendra Rajonale Dispeçerike si dhe veprimet e programuara nga Palët që ndikojnë në funksionimin e Sistemit Energjetik.
Rregullatori	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
Kthina Matëse	Paraqet tërësinë e sistemit matës prej TMRR, TMT, njehsori me të gjitha elementet përcjellëse të mbyllura me një panel (orman; kthinë) të veçantë të mbyllur matjeje të energjisë elektrike.
Sistem Matës	Paraqet tërësinë e pajisjeve prej TMRR, TMT, njehsori me të gjitha elementet përcjellëse (orman; kthinë matëse, përcuesit, terminaleve etj.) të veçantë për matjeje të energjisë elektrike.
MID	Measurement Instrument Directive – Direktiva e Instrumenteve Matëse

6. Shtojcat



Shtojca 1

IEC 60051-1 {Ed.5.0}	Direct acting indicating analogue electrical measuring instruments and their accessories - Part 1: Definitions and general requirements common to all parts
IEC 60051-4 {Ed.4.0}	Direct acting indicating analogue electrical measuring instruments and their accessories. Part 4: Special requirements for frequency meters
IEC 60051-5 {Ed.4.0}	Direct acting indicating analogue electrical measuring instruments and their accessories. Part 5: Special requirements for phase meters, power factor meters and synchrosopes
IEC 60051-6 {Ed.4.0}	Direct acting indicating analogue electrical measuring instruments and their accessories. Part 6: Special requirements for ohmmeters (impedance meters) and conductance meters
IEC 60145 {Ed.1.0}	Var-hour (reactive energy) meters
IEC 60211 {Ed.1.0}	Maximum demand indicators, Class 1.0
IEC 60338 {Ed.1.0}	Telemetry for consumption and demand
IEC/TS 60514 {Ed.1.0}	Acceptance inspection of Class 2 alternating-current watthour meters
IEC/TR 60736 {Ed.1.0}	Testing equipment for electrical energy meters
IEC 61358 {Ed.1.0}	Acceptance inspection for direct connected alternating current static watt-hour meters for active energy (Classes 1 and 2)
IEC 62052-11 {Ed.1.0}	Electricity metering equipment (AC) - General requirements, tests and test conditions - Part 11: Metering equipment
IEC 62052-11 {Ed.1.0}	Electricity metering equipment (AC) - General requirements, tests and test conditions - Part 11: Metering equipment
IEC 62053-11 {Ed.1.0}	Electricity metering equipment (a.c.) - Particular requirements - Part 11: Electromechanical meters for active energy (classes 0,5, 1 and 2)
IEC 62053-21 {Ed.1.0}	Electricity metering equipment (a.c.) - Particular requirements - Part 21: Static meters for active energy (classes 1 and 2)
IEC 62053-21 {Ed.1.0}	Electricity metering equipment (a.c.) - Particular requirements - Part 21: Static meters for active energy (classes 1 and 2)
IEC 62053-22 {Ed.1.0}	Electricity metering equipment (a.c.) - Particular Requirements - Part 22: Static meters for active energy (classes 0,2 S and 0,5 S)



Shtojca 2

Current Transformers	Current Transformers
IEC 60044-1-am1 {Ed.1.0}	Amendment 1 - Instrument transformers - Part 1: Current transformers.
IEC 60044-1-am2 {Ed.1.0}	Amendment 2 - Instrument transformers - Part 1: Current transformers.
IEC 60044-1 {Ed.1.2}	Instrument transformers - Part 1: Current transformers.
IEC 60044-3 {Ed.2.0}	Instrument transformers - Part 3: Combined transformers.
IEC 60044-8 {Ed.1.0}	Instrument transformers - Part 8: Electronic current transformers.

Shtojca 3

Voltage Transformers	
IEC 60044-2-am1 {Ed.1.0}	Amendment 1 - Instrument transformers - Part 2: Inductive voltage transformers
IEC 60044-2-am2 {Ed.1.0}	Amendment 2 - Instrument transformers - Part 2: Inductive voltage transformers
IEC 60044-2 {Ed.1.2}	Instrument transformers - Part 2 : Inductive voltage transformers
IEC 60044-3 {Ed.2.0}	Instrument transformers - Part 3: Combined transformers
IEC 60044-5 {Ed.1.0}	Instrument transformers - Part 5: Capacitor voltage transformers
IEC 60044-7 {Ed.1.0}	Instrument transformers - Part 7: Electronic voltage transformers